



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:080840

Datë: 10.05.2019

Numri i dokumentit: 00306840

P.nr. 245/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të pandehurit F...M... nga fsh. B..., K. e Gj..., për shkak të veprës penale, Lidhja e paautorizuar në shërbime, nga neni 321 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas Aktakuzës. PP.II. nr. 413/19, të datës 19.03.2019 të Prokurorisë Themelore, Departamenti Përgjithshëm në Gjilan, në bazë të nenit 253, par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK-së), pas mbajtjes së seancës gjyqësore, më datën 10.05.2019, nxjerr këtë,

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e arritur në mes të akuzuarit F... M... dhe të dëmtuarës ...Gj..., me përfaqësuesin me autorizim, D.. R..., e lidhur në Qendrën në Ndërmjetësimin në Gj..., më datë 25.04.2019, me numër Nd.....

II. HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, me nr. PP.II.nr. 413/19, të datës 19.03.2019 dhe Pushohet procedura penale kundër të akuzuarit për shkak se ka arritur marrëveshjen për ndërmjetësim me palën e dëmtuar .

III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjeteet buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, më datën 19.03.2019, ka parashtruar aktakuzën me nr. PP.II. nr. 413/19, kundër të akuzuarit..., për shkak të veprës penale Lidhja e paautoizuar në shërbime, nga neni 321 të KPRK-së.

Kjo gjykatë, me kërkesën e të akuzuarit dhe të dëmtuarit e ka dërguar lëndën në Zyren për Ndërmejtësim në....

Më dt. 25.04.2019, në Qendrën për Ndërmjetësim në Gj..., është arritur marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale përmes ndërmjetësimin në mes të të akuzuarit dhe të dëmtuarës

Qendra për Ndërmjetësim, më dt. 25.04.2019, me Vendimin Nd.-nr....., ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata, duke u bazuar në provat si më lartë, dhe në bazë të nenit 358 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, dhe nenit 12 par.12.5 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 245/2019, më 10.05.2019

Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar Ankesa. Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.